



| | | | | |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|---------------------|
| Pranuar / Dorezuar Primjenol/Prodato Received/Delivery | 13 - 01 | 2023 | 3 | viti god year |
| Organ./Njesia Organ./Jedinica Org./Unit | Nr Prot Br Prot Prot No | Shtojca Prilog Appendix | Sasia Kolicina Quantity | |
| SKANSER | 349/2023 | | 1170 | |



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1068/2022

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në çështjen juridike "kontestim konkursi", sipas ankesës me numër A.nr.1068/2022 të datës 30.11.2022 të parashtruar nga ankuesi nga Prishtina, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1, Nenin 16 paragrafi 3 nën paragrafin 1.1 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 13.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.1068/2022 e datës 29.11.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. *Anulohet* Vendimi me numër 22/2019 i datës 29.11.2022 i Komisionit për Ankesa në Zyrën Kombëtare të Auditimit si dhe të gjitha veprimet administrative procedurale të pasuara nga mbyllja e Konkursit më numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës Zyrtar për Buxhet dhe Financa deri në shpalljen e kandidatit fitues sipas Njoftimit me numër protokollit 2201 të datës 25.10.2022.
- III. *Mbetet në fuqi* Konkursi më numër reference RZBF/ZKA/18-09/22, i shpallur më datë 10.09.2022 nga Zyra Kombëtare e Auditimit, *ndërsa çështja kthehet* në fazën e vlerësimit të aplikacioneve.
- IV. *Obligohet* Drejtori i Përgjithshëm i Zyrës Kombëtare të Auditimit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në II dhe III të dispozitivit.
- V. Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 29.11.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 7496/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër 22/2022 të datës 29.11.2022 të Komisionit për Ankesa në Zyrën Kombëtare të Auditimit, me pretendimin së Zyra Kombëtare e Auditimit ka dështuar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për kandidatët që i janë nënshtruar testit me shkrim, rrethana kjo që rezultuar me privilegjim të individëve të caktuar duke pasur ndikim direkt në rezultatin final dhe së pyetjet e testit me shkrim gjinden gabime në përlllogaritje.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.12.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Zyra Kombëtare të Auditimit, ndërsa kjo e fundit më datë 14.12.2022 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të vendosjes.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas konstatimit së janë plotësuar kushtet për pranueshmerinë e ankesës në kuptim të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 7469/2022/2022 të datës 29.11.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 2219 të datës 29.11.2022 të Komisionit për Ankesa në Zyrën Këmbëmbare të Auditimit; Ankesën e datës 28.10.2022 të ankuesit drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesa në ZKA; Vendimin me numër të protokollit 2774 të datës 07.11.2022 të Komisionit të Ankesave në ZKA; Njoftimin për rezultatet e arritura në testin me shkrim me numër të protokollit 2148 të datës 14.10.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 7613/2022 të datës 02.12.2022; ankesë me numër të protokollit 8050/2022 të datës 14.12.2022; Konkursin e datës 10.09.2022 për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Vendimin me numër 1867 të datës 02.07.2022 për themelimin e Komisionit për Zhvillimin e Procedurave të Përzgjedhjes; Njoftimin me numër të protokollit 2028 të datës 07.10.2022 për listën e kandidateve të përzgjedhur për testin me shkrim; Dosjen e ankuesit së bashku me dokumentacionin e aplikimit si: Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatit ; Formularin e me numër të protokollit 1787 të datës 09.09.2022 për pranimin e dokumentacionit për aplikim për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa; Emalin e datës 13.09.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKM; copje e ID-së; Emalin e datës 15.09.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKM; Kontratën e punës me numër protokollit 3661 të datës 15.09.2022; Vërtetimin (pa numër) të datës 15.09.2022 lidhur me përvojën e punës; Kontratën e punës të datës 01.09.2020; Kontratën e punës të datës 03.09.2018; Emalin e datës 12.09.2022 të drejtuar burimeve njerëzore në ZKM; Formularin e aplikimit të datës 12.09.2022, Certifikatën shëndetësore për punësim nën shenjen CM0201; Diplomën Universitare me numër 7399 të datës 24.11.2016; Diplomën me numër 175/17 të datës 07.07.2017 me të cilën mori titullin Bachelor i Arteve në Marrëdhënie ndërkombëtare dhe Diplomaci; Vërtetimin e lëshuar nga Policia e Kosovës; Letër rekomandimin e datës 17.10.2018 të lëshuar nga Drejtori i Ministrisë së Integritimit Evropiane; Letër rekomandimin (pa datë dhe numër) të lëshuar nga Kolegji Ilirija; Letër rekomandimin (pa datë dhe numër) të lëshuar nga Kolegjin Ilirija; Letër rekomandimin (pa datë dhe numër) të lëshuar nga

Kolegjin Ilirija; Certifikatën penale të datës 26.07.2022 nën shenjen PN.NR/KR.BR 17544/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Pasqyrën e Trustit për periudhën kohore 22.01.2014-22.09.2021; Vërtetimin me Nr.05-711/1-405 të datës 25.07.2022; Dosjen e kandidatit _____ Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 për kandidatit _____ Emalin e datës 26.09.2022 të B.Tofaj drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKM; Formularin e datës 23.09.2022 për pranimin dokumentacionit për aplikim për "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 22.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKM; Formularin e aplikimit të datës 22.09.2022; Pasqyrën e Trustit Pensione për periudhën kohore 20.11.2017-08.08.2022; Kopje e ID-së; Diplomën Universitare me numër 7321 të datës 15.11.2016; Certifikatën Penale të datës 24.06.2022 nën shenjen PN.NR/KR.BR 810/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Deçan ; Letër rekomandimin e lëshuar nga Credit Link-CEO Qershor-2022; Dosjen e kandidatit _____ Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatit _____ ; Formularin për aplikim të datës 26.09.2022; Njoftimin me numër të protokollit 246 të datës 26.09.2022; Diplomën me numër 003/17 të datës 06.04.2017, Formularin zyrtar të datës 23.09.2022 të konkurrimit për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Kopje e ID-së; Aktin e emërimit të datës 11.11.2019; Certifikatën e datës 27.05.2020 lidhur me përfundimin e trajnimit "Moduli i aprovimeve dhe blerjeve zotimet dhe kërkesat për blerje;" Certifikatën e datës 31.12.2020 lidhur me përfundimin e trajnimit "Moduli i Pasurive"; Certifikatën lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit BDMS" për periudhën kohore 09 dhe 10 Qershor-2021; Certifikatën e datës 23.09.2021 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar trajnimin "Moduli i Menaxhimit të Pasurisë se Gatshme"; Certifikatën e datës lidhur me përfundimin e trajnimit "Programi i Investimeve Publike PIP" për periudhën kohore 28-31 Maj-2021; Certifikatën penale të datës 20.09.2022 nën shenjen PN.NR/KB.BR 24099/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Dosjen e kandidatës _____ Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatës _____ Emalin e datës 26.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin e datës 26.09.2022 për pranimin e dokumentacionit për aplikim për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 24.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKM; Formularin zyrtar të datës 24.09.2022 të konkursit për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Kopje e ID-së; Diplomën me numër 379 të datës 12.04.2004; Vërtetimin nën shenjen D-836; Certifikatën e datës 18.07.2018; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit për periudhën kohore 08.10.2007 deri me 01.12.2007; Shkresën e datës 25.11.00; Certifikatën penale të datës 01.07.2022 nën shenjen PN.NR/KR.Br 14272/22 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Deçan; Kartela e punës me numër ID-.11134; CV; Letër rekomandimin e datës 29.12.2010; Shkresën e datës 10.01.2011; Letër rekomandimin e datës 01.09.2000; Dosjen e kandidatit _____ Vlerësimin individual të datës 05.10.2022 të kandidatit _____ Emalin e datës 26.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin e datës 12.09.2022 për pranimit të dokumentacionit për aplikim për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 12.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Certifikatën e datës 02.05.2012; Certifikatën Penale të datës 29.07.2022 nën shenjen PN.NR/KR.Br.17587/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; Certifikatën e datës 28.05.2015 të lëshuar nga banka NLB; Pasqyrën e Trusti Pensional për periudhën kohore 18.08.2022-28.07.2022; Shkresën e datës 22.02.2018 lidhur me studimet e kandidatit; CV e kandidatit _____ Diplomën me Nr. 7449 të datës 15.12; Dokumentin e identifikimit; Formularin Zyrtar të datës 29.07.2022 të konkurrimit për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 25.09.2022 të _____ drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Certifikatën e datës 02.05.2012 të lëshuar nga ECDL Foundation; Certifikatën e datës 27.05.2015 lidhur me përfundimin e punës

praktike në NLB-Bank; Vërtetimin me numër 2987 të datës 23.09.2022 lidhur me përvojën e punës së kandidatit; Certifikatën Penale të datës 29.07.2022 nën shenjë PN.NR./Kr.Br të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë; CV; Dosjen e kandidatës [] Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatit [] Formularin me numër 1852 të datës 27.09.2022 për pranim të dokumentacionit për aplikim në pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 25.09.2022 të [] drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Diplomën me numër 1436 të datës 21.04.2006; Certifikatën e datës 11.11.1999 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 21.02.2000 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën lidhur me përfundimin e seminarit " Customer Care and Sales Management" për periudhën kohore 27.Qershor-01Korrik 2005; Dosjen e kandidatës E.Rukolli; Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatës [] Formularin me numër të protokollit 1851 të datës 27.09.2022 për pranim të dokumentacionit për aplikim për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 25.09.2022 të E.Rukolli drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin zyrtar të datës 25.09.2022 për pozitën e punës "Zyrtar për buxhet dhe Financa"; Diplomën Universitare me numër 4413 të datës 10.07.2014; Certifikatën (pa datë dhe numër); Dokumentin e identifikimit të kandidatës [] Referencën e lëshuar nga MOBIN lidhur me përvojën e punës së kandidatës; Vërtetimin lidhur me përvojën e punës në SHPK Euro Print"; Certifikatën (pa datë dhe numër), lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën Penale të datës 01.08.2022 nën shenjë PN.NR/KR.Br 2973/2022; Dosjen e kandidatit [] Vlerësimin individual të datës 05.10.2022 të kandidatit A.Bytyqi; Emalin me numër të protokollit 1854 të datës 26.09.2022 të [] drejtuar Zyres së Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin për pranim të datës 26.09.2022 të dokumentacionit për aplikim në pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 24.09.2022 të [] drejtuar Zyres së Personelit në ZKA; Diplomën Universitare me numër 476/16 të datës 11.03.2016; Diplomën Universitare me numër 187/13 të datës 17.12.2023; Certifikatën me numër 287/2020 të datës 22.09.2020; Shkresën e datës 07.07.2022 e lëshuar nga [] nga Institucioni KAF; Dokumentin e identifikimit; Formularin Zyrtar të datës 24.09.2022 të konkursit të kandidatit [] Vërtetimin e datës 07.04.2022 lidhur me përvojën e punës së kandidatit në Prima Engineering; Vërtetimin e datës 06.04.2022 lidhur me vërtetimin e përvojës së punës në Birra Prishtina; Vërtetimin e datës 08.04.2022 të përvojës së punës në MC-food; Vërtetimin për përvojën e punës së datës 08.04.2022 në Super Viva; Vërtetimin me numër 221 të datës 07.07.2022 lidhur me përvojën e punës në Kosava Thëngjill Sh.A; Pasqyren e Trustit pensional për periudhën kohore 16.01.2015 deri 14.09.2022; Certifikatën me numër 084-016 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën me anë të cilës dëshmohet se kandidati ka përfunduar me sukses trajnimin " Kontabilitetin dhe Legjislacionin e Ri Tatimor Deklarata Vjetore dhe Pasqyrat Financiare" Procedurat e Aplikimit dhe Marrjes së Granteve dhe Subvencioneve" në Shkurt 2021; Certifikatën 06.08.2021 të lëshuar nga Udhëheqësja e Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Institutin e Kontabilitetit për Auditim Financiar; Certifikatën me Nr.05-01/48/21 të datës 06.08.2021 të lëshuar nga KAF me anë të së cilës mori titullin Teknik i Kontabilitetit; Emalin e datës 23.09.2022 të [] drejtuar KGJK-se lidhur me aplikimin e certifikatës nën hetime për punësim; Emalin e datës 26.09.2022 të [] drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Emalin e datës 24.09.2022 të A.Bytyqi drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Certifikatën penale të datës 26.09.2022 nën shenjë PN.NR/KR.BR 3722/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë; Dosjen e kandidatës [] Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatës [] Formularin me numër të protokollit 1843 të datës 26.09.2022 për pranimin e dokumentacionit për

aplikim të kandidatës [redacted] Formularin e Zyrtar të datës 26.09.2022 të Konkursit për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa të kandidatës [redacted]"; Dokumentin e identifikimit; Vërtetimin me numër Ref. 11.1-570/22 të datës 20./09.2022 lidhur me përvojën e punës së kandidatës; Vendimin me numër Ref.ZM 25/12 të datës 25.01.2012 për emërimin e kandidatit në kabinetin e ministrit; Vendimin me numër Ref.ZM-433/13 të datës 25.09.2013 për emërimin e kandidatës në pozitën Asistente e lartë ekzekutive në Zyrën e Kryeministrit; Aktin e Emërimit me numër të protokollit 1467 të datës 02.06.2014; Diplomën me Nr.3152 të datës 27.03.2013; Diplomën 01.10.2001 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Autorizimin për qasje në SIMFK të datës 14.01.2015; Vërtetimin e datës 18.05.2013 me të cilën vërtetohet përvoja e punës së kandidatës në GW Legal LLC; Letër Rekomandimin e datës 14.04.2014; Letër referencën lidhur me përvojën e punës për periudhë kohore 15.10.2010 deri me 15.06.2010 në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Letër referencën nën shenjën Ref.02/05-11 të datës 28.02.2011 lidhur me përfundimin e praktikës si studente në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Certifikatën penale të datës 22.09.2022 nën shenjën PN.NR./KR.BR 24259/22 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë"; Dosjen e kandidatës [redacted]; Vlerësimin individual të datës 04.10.2022 të kandidatës [redacted] Emalin me numër të protokollit 1836 të datës 23.09.2022 të drejtuar Zyres së Personelit në ZKA; Formularin e datës 23.09.2022 për pranim të dokumentacionit për aplikim për "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Dokumentin e identifikimit; Formularin zyrtar të datës 21.09.2022 të konkursit për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Diplomën Universitare me numër 3498 të datës 22.07.2013; Vërtetimin e datës 08.03.2019 lidhur me statusin e studentit; Certifikatën me Nr.05-3/8 të datës 19.08.2019 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Drejtues në Instituti Kontabilitetit Auditimin Financa me të cilën kandidatja merr titullin Auditor i Certifikuar; Certifikatën me numër 05-02/28 të datës 14.12.2018 të lëshuar nga Kryetari i Këshillit Drejtues në Instituti Kontabilitetit Auditimin Financa me të cilën vërtetohet se kandidatja ka fituar titullin "Kontabilitet i Certifikuar"; Certifikatën me numër TK02/2015 të datës 21.12.2015 të lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv në Instituti Kontabilitetit Auditimin Financa me të cilën mori titullin "Teknik i Kontabilitetit"; Certifikatën e datës 13.07.2012 të lëshuar nga AFAS; Certifikatën e datës [redacted] lidhur me përfundimin e modulit "School of Entrepreneurship" të datës 29.04.2013 deri me 24.05.2013; Certifikatën e datës 17.06.2019 lidhur me përfundimin e kursit ALPHA WEB për periudhën Qershor 2019; Certifikatën me numër të licencës LN-8372-08-2014 të datës 08.06.2019 lidhur me përfundimin me sukses të trajnimit katër javor në fushën e financave; Letër rekomandimin me numër fiskal 600087159 Shtator-2012; Referencën e datës 16.12.2014 lidhur me përvojën e punës së kandidatit; Vërtetimin me numër të protokollit 1627 të datës 08.09.2022 lidhur me përvojën e punës së kandidatit; Certifikatën e Regjistrimit të biznesit të datës 09.01.2013; Shkresën e datës 09.01.2012 lidhur me informatën e biznesit; Certifikatën Themelore Profesionale të Prokurimit të vlefshme për vitin 2015-2017 të lëshuar nga Drejtoresha e Përgjithshmen në IKAP; Pasqyrën e Trustit pensional për periudhën kohore 29.12.2011 deri me 28.07.2022; Certifikatën e datës 12.08.2022 nën shenjën PN.Nr.KR/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me të cilën dëshmohet se ndaj kandidatës nuk është duke u zhvilluar procedure penale; Emalin e datës 23.09.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Dokumentin e identifikimit; Dosjen e kandidatës [redacted]; Vlerësimin Individual të datës 04.10.2022 të kandidatit [redacted]; Formularin me numër të protokollit 1788 të datës 19.09.2022 për pranimin e dokumentacionit për aplikim për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Formularin për pranim të dokumentacionit për aplikim për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 16.09.2022 të B.Mulaj drejtuar Burimeve Njerëzore

në ZKA; Formularin e datës 16.09.2022 të konkursit për pozitën "Zyrtar i Lartë për Buxhet dhe Financa"; Certifikatën me Nr.30/9 të datës 13.02.2007 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës lidhur me përfundimin e provimeve në Fakultetin Ekonomik; Diplomën Universitare me Nr.231 të datës 22.03.20007; Certifikatën e notave me numër 12/3353 të datës 28.09.2021; Vërtetimin e datës 05.04.2022 lidhur me përvojën e punës së kandidatës; Certifikatën penale të datës 04.04.2022 nën shenjën PN.NR./KR.Br.Nr.860/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Deçan; Vërtetimin e datës 04.04.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës; Dokumentin e identifikimit; Plotësim ndryshimin e Akt emërimit të datës 01.02.2022; Aktin e emërimit të datës 28.03.2012; Pasqyrën e Trustit pensional për periudhën kohore 01.08.2022-06.07.2022; Formularin me numër të protokollit 17/3049 të datës 28.06.2022 për mbrojtjen e punimit të diplomës; Kontratën e punës të datës 16.11.2009; Aktin e emërimit të datës 19.03.2013; Dosjen e kandidatës : Vlerësimin individual të datës 03.10.2022 të kandidatit Formularin për praninë të dokumentacionit për aplikim të datës 01.09.2022; Formularin e datës 14.09.2022 për praninë të dokumentacionit për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa"; Emalin e datës 14.09.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin Zyrtar të datës 14.09.2022 të konkurrimit për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" ; Dokumentacionin e identifikimit; Diplomën me numër 023/17 të datës 15.06.2017; Diplomën me numër 2198 të datës 16.03.2009; Vërtetimin (pa datë dhe numër) lidhur me marrëdhënien e punës; Certifikatën me numër 03-136 të datës 02.03.2016 lidhur me marrëdhënien e punës në Procredit Banke; Pasqyrën e llogarisë së Trustit Pensional për periudhën kohore 10.8.2002-09.09.2022; Certifikatën e datës 25.04.2022 lidhur me përfundimin e trajnimit "Basic Accounting Training"; Certifikatën e datës 09-10.09.2014 të lëshuar nga USAID; Certifikatën e datës 08.11.2012 lidhur me përfundimin e trajnimit "Parandalimi i shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit"; Certifikatën lidhur me përfundimin e trajnimit "Customer Care dhe SALES" të mbajtur me datë 19-23.09.2005; Certifikatën lidhur me përfundimin e kursit "Management Skills" nga data 30.09 deri me 04.10.2002; Vërtetimin e datës 13.09.2022 të lëshuar nga Policia e Kosovës; Certifikatën e datës 15.09.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë të cilën dëshmohet se ndaj kandidatës nuk është duke u zhvilluar procedure penale; Dosjen e kandidatës A.Sahiti: Vlerësimin Individual të datës 03.10.2022 të kandidatës A.Sahiti; Formularin me numër të protokollit 1761 të datës 13.09.2022 për praninë e dokumentacionit për aplikim për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" për kandidaten ; Emalin e datës 13.09.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Formularin zyrtar të datës 13.09.2022 të konkursit për pozitën e punës "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" të kandidatës Dokumentin e identifikimit; CV; Vërtetimin e datës 24.06.2022 lidhur me përvojën e punës në EKOPCK-SHPK; Letrën konfirmimin e datës 01.03.2019 lëshuar nga Drejtori Ekzekutiv në AMIK; Kontratën për angazhimin në punë praktike në Ministrinë e Financave; Diplomën me numër 7299 të datës 04.11.2016; Certifikatën e datës 30.04.2018 lidhur me pjesëmarrjen në trajnimin "Përdorimi i QUICKBOOKS; Certifikatën e datës 13.07.2017 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 05.12.2016 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Certifikatën e datës 09.06.2010 lidhur me përfundimin e kursit të gjuhës angleze; Pasqyrën e Trustit Pensional të datës 11.11.2016-15.06.2022; Certifikatën e datës 01.08.2022 nën shenjën PN.NR./KR.Br 3490/2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Vushtrri lidhur me dëshminë se ndaj kandidatës nuk është duke u zhvilluar procedure penale; Listën e datës 11.10.2022 lidhur me nënshkrimet e kandidateve që kanë qenë pjesëmarrës në testin me shkrim; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 për kandidaten ; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës F.Fejza; Vlerësimin e testit

me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatet ; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës ; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës ; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës ; Vlerësimin e testit me shkrim të datës 11.10.2022 të kandidatës Listën e datës 21.10.2022 lidhur me nënshkrimin e pjesëmarrësve në intervistë; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatës Pyetjet e intervistës me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatit ; Pyetjet për intervistën me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatës ; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatit Pyetjet për intervistën me gojë të datës 21.10.2022 për kandidaten Pyetjet e intervistës me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatit Pytjet e intervistës me gojë të datës 21.10.2022 të kandidatit Vendimin me numër të protokollit 2218 të datës 29.11.2022 të Komisionit për Ankesa; Procesverbalin me numër të protokollit 2219 të datës 22.11.2022; Seanca dëgjimore për çështje ankimore me numër 2219 të datës 28.10.2022; Emalin e datës 18.11.2022 të drejtuar burimeve njerëzore në ZKA; Emalin e datës 18.11.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Emalin e datës 20.11.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Emalin e datës 21.11.2022 të drejtuar Burimeve Njerëzore në ZKA; Procesverbalin me numër 2401 të datës 21.11.2022 të Komisionit për Ankesa për dëgjimin e dëshmitareve rreth pretendimeve të ankesës 2219; Procesverbalin me numër të protokollit 2402 të datës 21.11.2022 të Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesës 2219 nga dhe Vendimin me numër 2274 të datës 07.11.2022 të Komisionit të Ankesave; Emalin e datës 17.11.2022 të Burimeve Njerëzore drejtuar lidhur me seancën dëgjimore; Emalin e datës 15.11.2022 të drejtuar Zyres së Burimeve Njerëzore; Procesverbalin me numër të protokollit 2275 të datës 07.11.2022 të Komisionit të Ankesave për shqyrtimin e ankesave ndaj njoftimit për kandidatin e suksesshëm për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" me Nr.ref.RZBF/ZKA/18-09/22; Ankesën me numër të protokollit 2219 të datës 29.10.2022 të drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ZKA; Ankesën me numër protokollit 2526 të datës 21.10.2022 të drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave në ZKA; Emalin me numër të protokollit 96/2023 të datës 06.01.2023 të drejtuar KPMSHC-së; Emalin e datës 05.01.2022 të KPMSHC-së drejtuar Njoftimin për kandidatin e përzgjedhur me numër 2201 të datës 25.10.2022; Raportin përfundimtar me numër të protokollit 2194 të datës 24.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" emalin e datës 13.01.2023 të drejtuar

Kolegji i Këshillit pasi ka shqyrtuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha provat së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësishëm të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuar pretendimet ankimore të ankuesit, *sepse:*

Kolegji i Këshillit duke ju referuar Aktgjykimit në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020 të Gjykatës Kushtetuese, konstatoi se Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë është i zbatueshëm nga data 09.07.2020 dhe se me dispozitat e nenit 32 paragrafi 3 të të njëjtit ligj përcaktohet se: *Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligji*, Rrjedhimisht, nga analizimi i Aktgjykimit në rastin nr.KO203/19 të datës 09.07.2020, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të caktuara të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji i Këshillit ka gjetur se Gjykata Kushtetuese në pikën 207 ka konstatuar se: *Institucionet e*

Pavarura kushtetuese, bazuar në Kushtetutë, janë të autorizuar që të vendosin për organizimin e tyre të brendshëm duke përfshirë rregullimin e disa specifikave lidhur me personelin e tyre, që të sigurojnë pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative. Andaj, Gjykata theksoi se, sipas Kushtetutës dhe ligjeve përkatëse, si dhe praktikës gjyqësore të kësaj Gjykate, të elaboruar detajisht në Aktgjykim, ndaj personelit të institucioneve të pavarura kushtetuese aplikohen rregullat e shërbimit civil për atë që ato nuk cenojnë pavarësinë e tyre...".

Për sa me sipër, Kolegji i Këshillit ju referua edhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 15 paragrafin 1, me të cilin është përcaktuar se: *"Legjislacioni përkatës për shërbimin civil, nuk zbatohet vetëm Auditorin e Përgjithshëm, Zëvendës auditorin e përgjithshëm, Ndihmës auditorët e përgjithshëm dhe Auditorët e Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa stafi tjetër trajtohet në bazë të Ligjit për Shërbimin Civil".*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë së Zyra Kombëtare për Auditim, më datë 10.09.2022 ka rishpall konkursin e jashtëm më numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës Zyrtar për Buxhet dhe Financa, e në të cilin konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, ku i njëjti i është nënshtruar të gjitha fazave të vlerësimit të kësaj procedure të pranimit.

Bazuar në Raportin Përfundimtar të datës 24.10.2022 të Komisionit të Pranimit, ankuesi është vlerësuar me gjithsej 69.67 pikë duke u renditur si kandidati i tretë, ndërsa kandidati është vlerësuar si kandidati me më shumë pikë gjithsej 74.20 pikë, dhe së i njëjti sipas Njoftimit me numër protokollit 2201 të datës 25.10.2022 është shpall kandidati fitues për pozitën Zyrtar për Buxhet dhe Financa.

Ankuesi i pakënaqura me Vlerësimin e Komisionit të Pranimit, ka parashtruar ankesë në Komisionin e Ankesave të Zyrës Kombëtare të Auditimit, ndërsa ky i fundit me vendimin e kundërshtuar me ankesë gjegjësisht me Vendimin me numër të protokollit 22/2022 të datës 29.11.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pabazuar duke lenë në fuqi Njoftimin për kandidatin e suksesshëm lidhur me procesin rekrutues me numër reference RZB/ZKA/18-09/22 të datës 07.10.2022, me arsyetimin së nuk ka rritur të argumentoj se ka në këtë proces të rekrutimit ka pasur shkelje sistematike dhe diskriminuese ndaj kandidateve në testim më shkrim e cila do të cenonte rëndë integritetin dhe kredibilitetin e që rrjedhimisht do të kishte ndikim të theksuar në rezultatin përfundimtar të këtij procesi të rekrutimit.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr.22/2022 të datës 29.11.2022 të Komisionit për Ankesa, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civilë, me pretendimet ankimore së Zyra Kombëtare e Auditimit ka dështuar në krijimin e një ambienti të përshtatshëm për kandidatët që i janë nënshtruar testit më shkrim, rrethanë kjo që rezultuar me privilegjim të individëve të caktuar duke pasur ndikim direkt në rezultatin final. Me tej ankuesi shton së kandidati fitues gjatë testit me shkrim fillimisht ka nxjerr telefonin nga xhepi duke e vendosur në tavolinë me arsyen se me pengon në xhep, dhe së asnjëri nga anëtarët e Komisionit nuk reagon lidhur me këtë veprim të kandidatit fitues, dhe së i njëjti pas disa minutave e hap telefonin dhe bisedon i pa shqetësuar nga anëtarët e Komisionit dhe së pyetjet e testit me shkrim gjinden gabime në përlllogaritje.

Sipas Konkursit me numër reference RZBF/ZKA/18-09/22, si kritere/kërkesa për pozitën e shpallur janë përcaktuar: *Diploma e fakultetit dhe dy vite përvojë punës profesionale, preferohet përvojë pune në planifikim dhe analiza.* Ndërsa lidhur me dokumentacion e aplikimi janë përcaktuar: *Formulari i aplikimit, Dokument i identifikimit, dëshmi lidhur me arsimin dhe përvojën e punës, dëshmi nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë si dhe dëshmi së nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga pozita e zyrtarit publik.*

Lidhur me shqyrtimin e perëndimeve ankimore Kolegji i Këshillit ka analizuar vendimin e kundërshtuar me ankesë dhe rrjedhimisht ka konstatuar së Komisioni për Ankesa në Zyrën Kombëtare të Auditimit me rastin e nxjerrës së Vendimit me Nr. 22/2022 të datës 29.11.2022 nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale, sepse bazuar në dëshmitë e tre kandidateve aplikues të dëgjuar në cilësi të dëshmitareve si dhe bazuar në dëshminë e Kryesuesit të Komisionit të Pranimit rrjedhë së me leje të Kryesuesit të Komisionit kandidati A. Bytyci i ishte lejuar komunikimi me telefon (mobile) gjatë kohës sa mbahej testi me shkrim dhe në objektin (sallën) ku mbahej testi, me pretendimin se telefonata ishte e natyrës urgjente. Andaj, në vlerësimin e Kolegjit lejimi i komunikimit me telefon gjatë kohës së zhvillimit të testimit me shkrim nga kandidati tani i shpallur si kandidat fitues dhe përkundër faktit së mospërdorimi i telefonave mobil ishte deklaruar si kërkesë e detyrueshme nga Komisioni i Pranimit, cilësohet si veprim që pengon jo vetëm mirëvajtjen e procesit të testimit, por si i tillë cenon edhe intergjetin e procesit të rekrutimit dhe rrjedhimisht ky veprim bie ndesh edhe me dispozitat e nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku shprehimisht thuhet se: *“Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca...”*

Ne vështrim të dispozitave e ligjore të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji ka analizuar shkrësat e lëndës referuar plotësisht të kritereve të përcaktuara me konkursin me numër reference RZBF/ZKA/18-09/22, dhe si rrjedhojë ka gjetur së kandidatet aplikues nuk kanë ofruar dëshmi të mjaftueshme lidhur me përvojën profesionale të punës pas diplomimit, rrjedhimisht ashtu siç është konstatuar edhe nga Gjykata e Apelit sipas Aktvendimit me numër AA.nr.614/2022 të datës 27.09.2022, vërtetimi dhe referenca lidhur me përvojën e punës në sektorin privat nuk janë prova të mjaftueshme dhe të vlefshme për të dëshmuar përvojës profesionale të punës, pasi që të njëjtat nuk janë të shoqëruara me Kontratë tw punës dhe dëshmi nga organet përgjegjëse gjegjësisht Administrata Tatimore dhe Fondi i Kursimeve Pensioneve, andaj mbi këtë bazë të konstatimit, Njësia e Burimeve Njerëzore të Zyrës Kombëtare të Auditimit wshtw e obliguar qw me rastin e rivlerësimit tw aplikacioneve të kandidateve, të marr parasysh dhe të siguroj që përvoja e punës së kandidateve të jetë e shoqëruar me dokumentacionin përkatës tw specifikuar si me lart.

Bazuar si me sipër dhe meqenëse akti i shpalljes së Konkursit me numër reference RZBF/ZKA/18-09/22 për pozitën e punës Zyrtar për Buxhet dhe Financa, nuk është përfshirë me të meta ligjore, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi që të anulohen të gjitha veprimet administrative të pasuara nga mbyllja e Konkursit më numër reference RZBF/ZKA/18-09/2 deri në Njoftimin e datës 25.10.2022, me detyrimin që organi i punësimit në këtë rast Zyra Kombëtare e Auditimit të merr parasysh të gjeturat dhe pikëpamjet juridike sipas këtij vendimi, në mënyrë që tw

respektohet parimi i pranimit në shërbim civil i përcaktuar me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku parashihet se: "Pranimi në detyrë i nëpunësit civil, nëpunësit të Shërbimit Publik dhe nëpunësit administrativoteknik dhe mbështetës, bazohet në parimet e mundësive të barabarta, meritës dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe proporcional gjinor dhe të komuniteteve. 2. Pranimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, kryhet nëpërmjet një procesi përzgjedhës profesional, transparent e të drejtë, që garanton mundësi të barabarta për kushte të barabarta dhe përzgjedhjen e kandidatëve më të kualifikuar për kryerjen e detyrave përkatëse, duke garantuar përfaqësim minimal të komuniteteve dhe të gjinive. 3. Procesi përzgjedhës, sipas paragrafit 2 të këtij neni, bazohet në vlerësimin e njohurive, aftësive dhe cilësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të përgjithshëm, që përfshin një testim me shkrim dhe me gojë, si dhe çdo formë tjetër të përshtatshme të vlerësimit."

Përmbledhur si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1068/2022:

Ilire Mehmeti Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhinikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën Kombëtare të Auditimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.